



SHOQATA GJERMANE E INDUSTRISE DHE TREGTISE NE SHQIPERI

STATUTI

I.

EMRI, SELIA, OBJEKTIVAT DHE DETYRAT

Neni 1

- 1.1 Emri i shoqatës është “Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri”, në vijim e referuar si **”Shoqata”**.
- 1.2 Anëtarët themelues të Shoqatës janë:
 1. **“Auto Star Albania” SHPK përfaqësuar nga Z. Basri Ruka,**
 2. **“Sprint Marketing and Management Consulting” SHPK përfaqësuar nga Erleta Kastrati.**
 3. **“Classic” SHPK përfaqësuar nga Z. Artan Qesko.**
 4. **“Bindi” SHPK përfaqësuar nga Z. Hysen Ruka.**
 5. **“H.L – Group” SHPK përfaqësuar nga Z. Hari Lena.**
 6. **“Tirana International Airport” SHPK përfaqësuar nga Znj. Andrea Gebbeken.**
 7. **“Weissgerber&Partner” SHPK përfaqësuar nga Z. Daniel Richter.**
 8. **“ProCredit Bank” SHA përfaqësuar nga Znj. Anila Denaj dhe Z. Borislav Kostandinov**
 9. **“Tuv Rheinland” Zyre përfaqësimi përfaqësuar nga Z. Pirro Cajupi**
- 1.3 Shoqata themelohet në përputhje me të drejtën shqiptare dhe regjistrohet si e tillë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 1.4 Selia e shoqatës është Rruga Kavajës Nr.116, Tiranë, Shqipëri.
- 1.5 Shoqata ka logon dhe vulën e saj.
- 1.6 Shoqata krijohet për një periudhë kohe të pacaktuar.

Neni 2

Shoqata ka për qëllim të përmbushë objektivat e mëposhtëm:

1. Nxitjen e marrëdhënieve ekonomike mes Shqipërisë dhe Gjermanisë.



2. Përfaqësimin e interesave të anëtarëve të saj, duke marrë parasysh veprimtarinë e tyre ekonomike në kuadrin e marrëdhënieve ekonomike shqiptaro-gjermane, me qëllimin afatgjatë për të mbështetur krijimin e një dhome zyrtare tregtare gjermane jashtë vendit.
3. Shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave në fushën tregtare dhe industriale.
4. Ndërmjetësimin, përkujdesjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të biznesit ndërmjet sipërmarrjeve të të dyja vendeve.
5. Vendosjen dhe ruajtjen e kontakteve ndërmjet subjekteve ekonomike dhe institucioneve të interesuara të të dyja vendeve.
6. Publikimin e botimeve me tema ekonomike me interes të dyanshëm.
7. Mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi gjendjen ekonomike në të dy vendet.
8. Mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi mundësitë e tregut, punësimit dhe investimeve në të dy vendet.
9. Mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi kuadrin ligjor të ushtrimit të veprimtarive ekonomike në të dy vendet si edhe në Bashkimin Europian.
10. Organizimin e veprimtarive informuese për temat e përmendura si dhe veprimtari me natyrë shoqërore.
11. Ndërmarrjen e çdo lloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji e cila i shërben objektivave të përmendura më sipër të shoqatës.

Neni 3

Shoqata nuk kryen asnjë lloj veprimtarie me karakter politik, fetar dhe botëkuptimi.

Neni 4

Shoqata ushtron veprimtarinë në bashkëpunim të ngushtë dhe të besueshëm me autoritetet shtetërore dhe institucionet e rëndësishme për punën e saj në të dy vendet, si dhe në Bashkimin Europian. Kjo vlen në veçanti për marrëdhëniet me Shoqatën e Dhomave të Industrisë dhe Tregtisë (DIHK) në Berlin dhe për Ambasadën Gjermane në Tiranë.

II. BURIMET FINANCIARE, PËRGJEGJËSITË

Neni 5

Shoqata është jo fitimprurëse dhe veprimtaria e saj nuk ka synime fitimi.

Neni 6

6.1 Mjetet financiare të shoqatës e kanë prejardhjen nga burimet e mëposhtme:

- Kontributet e anëtarëve
- Ndihma të institucioneve publike
- Veprimtari ekonomike në kuadrin e detyrave të përcaktuara në Statut
- Të ardhura të tjera të cilat realizohen në kuadrin e veprimtarive të përcaktuara në Statut.

6.2 Anëtarët nuk gëzojnë asnjë të drejtë mbi pasurinë e Shoqatës dhe shpërblime të tjera materiale apo financiare, përveç pagave, shpërblimit dhe kompensimeve të cilat rrjedhin nga marrëdhëniet e rregullta të punës ose shërbimet të cilat janë ngarkuar shprehimisht nga Shoqata.

Neni 7

I vetmi organ i cili ka të drejtë të administrojë pasurinë e shoqatës është Bordi i Drejtorëve. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen sipas rregullave përkatëse. Bordi i Drejtorëve përgjigjet dhe jep llogari përpara Asamblesë së Përgjithshme për administrimin e pasurisë së shoqatës.

Neni 8

8.1 Shoqata përgjigjet për detyrimet e saj vetëm nëpërmjet pasurisë së saj. Anëtarët e shoqatës dhe anëtarët Bordit të Drejtorëve janë të përjashtuar nga çdo përgjegjësi ligjore civile.

8.2 Punëmarrësit dhe organet e Shoqatës përgjigjen para të tretëve në kuadrin e veprimtarisë së tyre brenda Shoqatës vetëm në rastin e veprimeve me dashje apo nga pakujdesia e rëndë.

Neni 9

Ne rast se Shoqata shpërndahet, pasuria e saj do t'i transferohet një institucioni i cili ndjek objektiva të ngjashme me ato të Shoqatës, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



III ANËTARËSIA

Neni 10

- 10.1 Anëtarë të shoqatës mund bëhen shoqëri, organizata si dhe persona fizikë të cilët luajnë një rol aktiv në kuadrin e marrëdhënieve ekonomike bilaterale shqiptaro-gjermane, si p.sh. duke përfaqësuar ndonjë shoqëri.
- 10.2 Çdo anëtar i Shoqatës regjistrohet në regjistrin e anëtarëve i cili mbahet nga shoqata për këtë qëllim.
- 10.3 Anëtari i shoqatës gëzon të drejtat e mëposhtme:
- Të votojë për miratimin ose jo të çështjeve të cilat shtrohen për diskutim në çdo mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të anëtarëve;
 - Të njoftohet për çdo vendim të marrë nga organet e shoqatës;
 - Të marrë pjesë në zgjedhjen e organeve drejtuese të shoqatës dhe të zgjidhet në këto organe;
 - Të marrë pjesë në aktivitetet e shoqatës;
 - Të ketë mendim të ndryshëm mbi vendimet e shoqatës në përputhje me këtë Statut (veçanërisht në përputhje me nenin 10.4 a);
 - Të ushtrojë çdo lloj të drejte tjetër të njohur me ligj e cila i shërben ushtrimit të të drejtave të sipërpërmendura.
- 10.4 Anëtari ka detyrimet e mëposhtme:
- Të respektojë vendimet e shoqatës;
 - Të mbështesë aktivisht çdo veprimtari të Shoqatës;
 - Të marrë në konsideratë detyrat e shoqatës;
 - Të paguajë rregullisht kontributet e anëtarësimi;
 - Të ndjekë dhe përmbushë çdo detyrim tjetër ligjor në shërbim të shoqatës.

Neni 11

- 11.1 Pranimi i një anëtari të ri në shoqatë realizohet mbi bazën e kërkesës së tij me shkrim. Bordi i Drejtorëve është organi që vendos mbi kërkesën e anëtarësimi me shumicë të thjeshtë votash. Për të marrë vendim të rregullt duhet të jenë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të Kryesisë.
- 11.2 Kërkuesi konfirmon duke firmosur kërkesën për anëtarësim se pranon Statutin e shoqatës në fuqi dhe se plotëson kushtet për anëtarësim. Bordi i Drejtorëve mund të refuzojë kërkesën për anëtarësim pa qenë e detyruar të japë arsytet.



- 11.3 Nëse është e nevojshme Bordi i Drejtorëve para se të vendosë për ndonjë kërkesë anëtarësimi mund të ushtrojë të drejtën e saj për të kërkuar dëshmi rreth punëve të kërkuarit. Anëtarësia fillon nga momenti i pagimit të kontributit të anëtarit.

Neni 12

- 12.1 Çdo shoqëri anëtare person juridik cakton, duke rezervuar të drejtën e riemërimit, një person fizik nga niveli i saj drejtues për ta përfaqësuar atë në shoqatë.
- 12.2 Anëtarët duhet të njoftojnë Kryesinë brenda 14 ditëve në lidhje me cdo ndryshim thelbësor i cili prek kushtet e cilësisë së tyre si anëtarë si edhe për ndryshimin e adresës apo të përfaqësuesit të tyre. Kjo vlen në mënyrë analoge edhe për personin fizik në përputhje me Nenin 10.1. Këta të fundit duhet të njoftojnë për përfundimin apo ndryshimin e marrëdhënieve të përfaqësimit si dhe për rastet e largimit nga shoqëria nën emrin e së cilës ishte kryer pranimi.

Neni 13

- 13.1 Statusi i anëtarësimit mbaron:
- a) Në rast vdekjeje të anëtarit, kur ai është person fizik;
 - b) Në rast mospërtëritjeje të anëtarësisë pas mbarimit të afatit ose ndërprerje të saj brenda vitit financiar (i cili njoftohet 3 muaj para përfundimit të vitit financiar).
 - c) Në rast përjashtimi sipas dispozitave të Nenit 14;
 - d) Në rast likuidimi/falimentimi të shoqërisë apo organizatës kur bëhet fjalë për anëtarësinë e një personi juridik.
- 13.2 Anëtar i shoqatës nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e kontributeve financiare të anëtarësisë të paguara në rast se del apo largohet nga shoqata përpara mbarimit të vitit financiar.

Neni 14

Bordi i Drejtorëve mund të përjashtojë çdo anëtar nga shoqata në rast shkeljeje të rëndë të Statutit, kur zbulohen fakte të cilat mund dëmtojnë reputacionin e shoqatës, kur nuk ka paguar kuotën e anëtarësimit deri në gjysmën e vitit kalendarik përkatës, ose kur i ndalohej me ligj cilësia e anëtarit të shoqatës. Ky vendim mund të ankimohet në Asamblenë e rregullt të radhës. Asambleja është organi kompetent, i cili merr vendimin përfundimtar të përjashtimit, i cili mund të kundërshtohet prej anëtarit të përjashtuar në gjykatën kompetente shqiptare.



IV. ORGANET E SHOQATËS

Neni 15

Shoqata përbëhet nga organet e mëposhtme:

1. Asambleja e Anëtarëve;
2. Bordi i Drejtorëve;
3. Presidenti;
3. Administratori;
4. Auditorët.

ASAMBLEJA E ANETAREVE

Neni 16

Asambleja gëzon kompetencat e mëposhtme:

1. Vendos për çështje të Statutit, përfshirë ndryshimin e tij;
2. Miraton raportin vjetor të shoqatës, udhëzimet dhe planin operacional;
3. Miraton bilancin dhe buxhetin vjetor;
4. Vendos për ndryshimet e objektit dhe politikave të shoqatës;
5. Vendos për krijimin dhe mbylljen e degëve dhe formave të tjera organizative të shoqatës;
6. Vendos për ankimet e anëtarëve sipas nenit 14;
7. Zgjedh auditorët dhe Bordin e Drejtorëve me përjashtim të anëtarëve *ex-officio*;
8. Përcakton shumën e kontributeve vjetore;
9. Vendos me dy të tretat e votave mbi shpërndarjen e shoqatës;
10. Vendos mbi çështje të tjera të cilat nuk janë në kompetencë të ndonjë organi tjetër të shoqatës;
11. Miraton rregulloret për organizimin e brendshëm të shoqatës ose ngarkon dhe autorizon Bordin e Drejtorëve për ta kryer këtë funksion.

Neni 17

- 17.1 Çdo anëtar i cili ka derdhur rregullisht kuotën përkatëse gëzon të drejtën e një vote në Asamble. Për personat juridikë, e drejta e votës së anëtarit ushtrohet nga personi fizik i autorizuar për këtë qëllim. E drejta e votës së një anëtarit mund të ushtrohet nga një anëtar tjetër i autorizuar për këtë qëllim. Çdo anëtar mund të autorizohet të përfaqësojë jo më shumë se tre anëtarë të tjerë.
- 17.2 Vendimet e Asamblesë merren me votim të hapur. Zgjedhja e organeve të shoqatës, me përjashtim të Kontrollorëve bëhet me votim të fshehtë.



Neni 18

Asambleja e zakonshme thirret nga Presidenti i shoqatës një herë në vit, jo më vonë se fundi i muajit qershor. Ftesa për mbledhje duhet të dërgohet një muaj përpara datës së planifikuar.

Neni 19

Propozimet e anëtarëve për t'u paraqitur në Asamble për votim duhet të depozitohen pranë Bordit të Drejtorëve jo më vonë se dy javë përpara datës së mbledhjes të shoqëruar me argumentet përkatëse. Propozimet Bordi i Drejtorëve duhet t'ua përcjellë anëtarëve.

Neni 20

- 20.1 Asambleja mund të marrë vendime vetëm kur thirret në mënyrë të rregullt dhe në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të shoqatës.
- 20.2 Asambleja i merr vendimet e saj me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm. Vendimet që lidhen me ndryshimin e statutit apo shpërndarjen e shoqatës miratohen me votat e dy të tretave të votave të vlefshme të anëtarëve të pranishëm.

Neni 21

Asambleja drejtohet nga Presidenti i shoqatës. Kur mungon Presidenti, ajo drejtohet nga zëvendëspresidenti dhe në mungesë të tij nga anëtari më i moshuar i Bordit të Drejtorëve. Asambleja cakton mbajtësin e procesverbalit. Procesverbali duhet t'i shpërndahet të gjithë anëtarëve dhe të miratohet gjatë mbledhjes së ardhshme të Asamblesë.

Neni 22

- 22.1 Asambleja e Jashtëzakonshme thirret nga Presidenti kur kërkohet nga Bordi i Drejtorëve ose nga një e pesta e anëtarëve që kanë shlyer rregullisht detyrimet e kuotave të anëtarësimi. Nëse Presidenti nuk e thërret Asamblenë e Anëtarëve brenda 14 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës, atëherë Asambleja thirret nga Bordi i Drejtorëve ose nga kërkuesit.
- 22.2 Dispozitat e neneve 16 deri 21 janë të vlefshme dhe në rastin e Asamblesë së Jashtëzakonshme.



BORDI I DREJTOREVE

Neni 23

Bordi i Drejtorëve ka kompetencat e mëposhtme:

1. Përgatit mbledhjen e Asamblesë, projekt-vendimet e saj dhe ndjek zbatimin e vendimeve;
2. Administron pasurinë e shoqatës dhe është përgjegjës për të;
3. Merr vendime në periudhën midis mbledhjeve të Asamblesë në lidhje me veprimtarinë e shoqatës në rast se këto vendime nuk janë kompetence ekskluzive e Asamblesë;
4. Mbikëqyr veprimtarinë e administratorit dhe në bashkëpunim me këtë të fundit, veprimtarinë e punëmarrësve;
5. I raporton rregullisht Asamblesë për veprimtarinë e saj;
6. Vendos për pranimin dhe përjashtimin e anëtarëve të shoqatës;
7. Zgjedh organe dhe funksione të tjera në përputhje me nenin 26.

Neni 24

Bordi i Drejtorëve të shoqatës përbëhet nga nëntë anëtarë, nga të cilët shtatë janë anëtarë të zgjedhur dhe dy anëtarë *ex officio*. Anëtarët *ex officio* janë:

- Një përfaqësues i Shoqatës Ekonomike Gjermano-Shqiptare të regjistruar si shoqatë në Berlin,
- Përfaqësuesi përgjegjës për Shqipërinë i rrjetit të Dhomave Gjermane të Tregtisë jashtë vendit.

Ndër anëtarët e zgjedhur të paktën tre duhet të jenë të kombësisë gjermane.

Në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve mund të marrë pjesë pa të drejtë vote Ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri ose një përfaqësues i emëruar prej tij.

Neni 25

- 25.1 Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve zgjat nga data e emërimit të tyre në këtë Statut ose nga Asambleja e Anëtarëve deri në mbledhjen e dytë të radhës të Asamblesë së Anëtarëve por në cdo rast jo më pak se dy vjet. Kur ndonjë prej anëtarëve të zgjedhur të Bordit të Drejtorëve largohet përpara mbarimit të mandatit, anëtarët e tjerë të Bordit të Drejtorëve kanë të drejtën të zgjedhin një anëtar tjetër për kohën e mbetur të mandatit. Zgjedhja duhet të aprovohet nga Asambleja e ardhshme e radhës. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve mund të rizgjidhen pa kufizim.



25.2 Bordi i Drejtorëve të shoqatës kanë të drejtë të zgjedhin deri në dy anëtarë të rinj, të cilët do të aprovohen në Mbledhjen e ardhshme të Asamblesë.

Neni 26

Bordi i Drejtorëve gjatë mandatit të tij zgjedh nga radhët e tij Presidentin, zëvendës-presidentin dhe përgjegjës të thesarit. Këta mund të rizgjidhen pa kufizim dhe nuk shpërblehen për punën e tyre. Antarët e parë të Bordit të Drejtorëve caktohen në këtë Statut dhe janë:

1. **Andrea Gebbeken (President);**
2. **Basri Ruka (Zv. President);**
3. **Artan Qesko (Përgjegjësi i Thesarit);**

Bordi i Drejtorëve emëron edhe Administratorin e shoqatës me shumicë të thjeshtë votash. E njëjta procedurë ndiqet edhe për shkarkimin e tij. Administratori kryen detyrat e tij në përputhje me kontratën e punës dhe pagën e caktuar nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 27

Bordi i Drejtorëve thërritet nga Presidenti në marrëveshje me Administratorin dhe anëtarët *ex-officio* të tij të paktën katër herë në vit duke lajmëruar me shkrim të paktën 14 ditë përpara datës së planifikuar të mbledhjes. Ftesa përmban të dhënat për vendin, datën, orën kur fillon dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Neni 28

Bordi i Drejtorëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash. Në rast barazimi të votave, rezultati i votimit përcaktohet nga vota e Presidentit ose, në mungesë të tij, nga vota e zëvendës-presidentit.

Neni 29

Vendimet e marra nga Bordi i Drejtorëve do të protokollohen. Protokollin duhet të miratohet me vendim në mbledhjen e ardhshme të radhës të Bordit të Drejtorëve. Vendimet duhet të pasqyrohen në një regjistër të posaçëm të vendimeve.

Kur ndonjë prej anëtarëve të Bordit të Drejtorëve ka interes të drejtpërdrejtë apo konflikt të mundshëm interesash në lidhje me ndonjë vendim, atëherë ai duhet të mos marrë pjesë në votim.



Neni 30

Protokollet dhe vendimet do të mbahen në gjuhën e vendosur nga Bordi i Drejtorëve dhe do të përkthehen në shqip, nëse gjuha e vendosur është gjermanisht apo anglisht. Ato do të përkthehen në gjermanisht nëse gjuha e vendosur është shqip.

PRESIDENTI

Neni 31

- 31.1 Presidenti i shoqatës përfaqëson shoqatën në marrëdhëniet me të tretët. Ai kryeson mbledhjet e Asamblesë dhe mbledhjet e Bordit të Drejtorëve. Në mungesë, Presidenti përfaqësohet nga zëvendëspresidenti dhe, në mungesë të këtij të fundit, nga Administratori.
- 31.2 Presidenti ngarkon Administratorin të administrojë së bashku me përgjegjësin e thesarit llogaritë bankare të shoqatës.

ADMINISTRATORI

Neni 32

- 32.1 Funkcionet ekzekutive të shoqatës do të kryhen nga një Administrator nderi ose punëmarrës me kohë të plotë në marrëveshje me Bordin e Drejtorëve. Administratorit mund t'i jepen edhe kompetenca të tjera me shkrim, nga Presidenti, në marrëveshje me Bordin e Drejtorëve.
- 32.2 Emërimi dhe pushimi nga puna i Administratorit bëhet nga Presidenti dhe, në mungesë të tij, nga zëvendëspresidenti në përputhje me nenin 26. Emërimi apo pushimi i punëmarrësve me kohë të plotë të shoqatës bëhet nga Administratori në marrëveshje me Bordin e Drejtorëve.

AUDITORËT

Neni 33

Asambleja e zakonshme e anëtarëve zgjedh dy auditorë për një mandat një vjeçar të cilët do të auditojnë llogaritë e vitit financiar të shoqatës dhe do t'i raportojnë Asamblesë së zakonshme së radhës. Mandati i tyre është i përtëritshëm.



DISPOZITA PËR SHPËRBËRJEN E SHOQATËS

Neni 34

34.1 Shoqata shpërbëhet:

- Me vendim të Asamblesë, me dy të tretat e votave;
- kur numri i anëtarëve zbret nën numrin minimal të përcaktuar në ligjin “Për organizatat jo-fitimprurëse”;
- me vendim gjyqësor të formës së prerë kur konstatohet se programi dhe Statuti i shoqërisë nuk janë në përputhje me Kushtetutën, ose
- në rastet e tjera të parashikuara me ligj.

34.2 Kur merret vendimi për shpërbërjen e shoqatës, ajo çregjistrohet, ndërpret veprimtarinë e saj dhe likuidohet sipas ligjeve në fuqi.

Neni 35

35.1 Ky Statut hartohet në gjuhën shqipe dhe atë gjermane. Në rast kundërshtish, versioni vendimtar për interpretimin e tij është Statuti në gjuhën gjermane.

35.2 Për çështje të diskutueshme që lindin nga ky statut do të vendosë një komision arbitrazhi që ngrihet rast pas rasti në përputhje me nevojat e Shoqatave të Dhomave Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Berlin. Në rast se ky komision nuk arrin të marrë një vendim apo kur një nga palët nuk është dakord me vendimin e marrë, do të ndiqen rrugët përkatëse ligjore pranë gjykatave kompetente shqiptare.

35.3 Kur një dispozitë e këtij Statuti është apo bëhet e pavlefshme apo e pazbatueshme dispozitat e tjera mbeten të vlefshme. Dispozitat e pavlefshme duhet të zëvendësohen me dispozita të vlefshme të cilat duhet të pasqyrojnë vullnetin e anëtarëve të shoqatës të shprehur gjatë hartimit të Statutit.